

**VENDIM**  
**Nr. 80. datë 28.12.2015**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                 |                                |   |   |   |
|-----------------|--------------------------------|---|---|---|
| Bashkim Dedja   | kryetar i Gjykatës Kushtetuese |   |   |   |
| Vladimir Kristo | anëtar i                       | “ | “ |   |
| Vitore Tusha    | anëtare e                      |   | “ | “ |
| Fatmir Hoxha    | anëtar i                       | “ |   | “ |
| Gani Dizdari    | anëtar i                       | “ |   | “ |
| Besnik Imeraj   | anëtar i                       | “ |   | “ |
| Fatos Lulo      | anëtar i                       |   | “ | “ |
| Sokol Berberi   | anëtar i                       | “ |   | “ |

me sekretare Edmira Babaj, në datën 21.10.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 62 Akti, që i përket:

**KËRKUES:** Astrit Avdulaj

**SUBJEKT I INTERESUAR:** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë

**OBJEKTI:** Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr. 00-2014-2918, datë 18.9.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”

**GJYKATA KUSHTETUESE,**

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë (DPTT), që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**VËREN:**

**I**

1. Kërkuarisi ka qenë punonjës i DPTT-së nga data 15.1.2009 deri në datën 15.2.2011. Me urdhrin nr. 134, datë 15.2.2011 të drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ai është njoftuar për largimin nga shërbimi civil.

2. Komisioni i Shërbimit Civil (KSHC), me vendimin nr. 119, datë 15.4.2011, ka vendosur pranimin e pjesës së kërkuarit, ndryshimin e masës disiplinore nga “Largim nga shërbimi civil” në “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë për një afat kohor një vit”, rikthimin e kërkuarit në detyrën që ka pasur më parë dhe detyrimin e DPTT-së të paguajë kërkuarin nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në zbatimin e vendimit.

3. Gjykata e Apelit Tiranë, pas ankimit të ushtruar nga DPTT-ja, me vendimin nr. 81, datë 20.9.2011, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 119, datë 15.4.2011 të KSHC-së.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-2918, datë 18.9.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 119, datë 15.4.2011 të KSHC-së dhe të vendimit nr. 81, datë 20.9.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke rrëzuar padinë e paditësit për shfuqizimin e vendimit nr. 134, datë 10.2.2011 të drejtorit të Përgjithshëm të DPTT-së.

**II**

5. **Kërkuesi** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), duke pretenduar se ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në Gjykatën e Lartë. Më konkretisht, ai ka parashtruar se vendimi i kundërshtuar, duke ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit dhe vendimin e KSHC-së, është në kundërshtim të plotë me ligjin material e procedural. Sipas kërkuesit, aktet e mbajtura nga grupi i rikontrollit janë të parregullta, të pasakta dhe në shkelje të ligjeve e procedurave përkatëse tatimore, shkelje të cilat Gjykata e Lartë i ka lënë në fuqi. Në këtë vendim Gjykata e Lartë, megjithëse ka konkluduar se nuk janë respektuar kërkesat e ligjit, nuk është shprehur për asnjë shkelje procedurale dhe e ka shqyrtuar çështjen në themel duke dalë nga juridiksioni i saj.

6. **Subjekti i interesuar** ka parashtruar se nga rikontrolli i kryer nga DPTT-ja ka rezultuar se kërkuesi ka vepruar në kundërshtim me legjislacionin tatimor gjatë ushtrimit të detyrës dhe shkeljet janë të provuara me akte shkresore. Vendimi i DPTT-së për largimin e kërkuesit nga shërbimi civil ka dalë në zbatim të ligjit, të procedurës së përcaktuar në ligj, si dhe në respektim të të gjitha drejtave të kërkuesit në lidhje me procedurën disiplinore.

### III

#### Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

##### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

7. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tij, të cilat i ka paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës, *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, si dhe *ratione materiae*, pasi pretendimet e paraqitura në kërkesë *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.

##### B. Për pretendimin e mosrespektimit të ligjit material e procedural

8. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 00-2014-2918, datë 18.9.2014 i Gjykatës së Lartë është marrë në kundërshtim të plotë me ligjin material e procedural, duke ndryshuar vendimin e Gjykatës së Apelit dhe vendimin e KSHC-së. Sipas kërkuesit, aktet e mbajtura nga grupi i rikontrollit janë të parregullta, të pasakta dhe në shkelje të ligjeve dhe procedurave përkatëse tatimore, shkelje të cilat Gjykata e Lartë i ka lënë në fuqi.

9. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Gjykata ka theksuar se mënyra e vlerësimit të provave dhe mënyra e zbatimit të ligjit material është si rregull atribut i gjykatave të zakonshme. Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit material apo zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme, pasi një gjë e tillë do ta kthente atë në një instancë të katërt (*shih vendimet nr. 34, datë 12.7.2013; nr. 1, datë 20.1.2012; nr. 23, datë 17.5.2011; nr. 31, datë 5.7.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit lidhur me mosrespektimin e ligjit material e procedural është haptazi i pabazuar.

##### C. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykatës së caktuar me ligj

10. Kërkuesi ka pretenduar se Gjykata e Lartë është shprehur jashtë juridiksionit të saj, pasi pa konstatuar ndonjë shkelje procedurale ka konkluduar se në rastin konkret nuk janë respektuar kërkesat e ligjit material në zgjidhjen e çështjes konkrete. Më tej, Gjykata e Lartë i është referuar ligjit nr. 9920/2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimit nr. 24, datë 2.9.2008 të Ministrit të Financave, të cilat, sipas kërkuesit, nuk kanë lidhje me çështjen konkrete.

11. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me*

ligj”. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin mbi çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërishit të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr. 40, datë 25.6.2015; nr. 2, datë 22.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

12. Në kuptim të funksionit rishikues të Gjykatës së Lartë, të sanksionuar në nenin 141 të Kushtetutës, Gjykata ka vlerësuar se kompetenca e saj për shqyrtimin e çështjeve nuk bazohet mbi të njëjtat dispozita procedurale të cilave u referohen gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit. Në nocionin kushtetues të rishikimit futet, në radhë të parë, shqyrtimi i rekurseve për pretendimet e shkeljes të ligjit material ose procedural, gjë që përbën funksionin kryesor të Gjykatës së Lartë (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009; nr. 31, datë 1.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Gjykata e Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe zgjidh vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit (*shih vendimet nr. 27, datë 24.6.2013; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte dhe prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra mbi mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt. Gjykata thekson se kusht për dhënien nga Gjykata e Lartë të një vendimi mbi themelin e çështjes, është që jo vetëm të mos nevojitet administrimi i provave të reja, por edhe që provat e administruara të jenë shqyrtuar dhe vlerësuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjyqtari i faktit (*shih vendimin nr. 40, datë 25.6.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin konkret, Gjykata e Lartë e ka shqyrtuar çështjen në seancë gjyqësore dhe në përfundim ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit dhe të vendimit të KSHC-së. Nga arsyetimi i vendimit rezulton se Gjykata e Lartë e ka prishur vendimin e KSHC-së dhe vendimin e Gjykatës së Apelit për shkak të mosrespektimit të ligjit material (*f. 4 e vendimit*). Gjykata e Apelit dhe KSHC-ja janë shprehur në vendimet përkatëse se “pala e paditur ka pretenduar se në punën e kërkuesit janë vërejtur raste të moszbatimit të orarit të punës (...) tabela e raportimit në fund të orarit zyrtar dhe aktkonstatimet e administruara gjatë shqyrtimit të çështjes në KSHC, vërtetojnë se kërkuesi ka qenë duke ushtruar detyrën kur është ushtruar kontrolli dhe për rrjedhojë konfirmojnë të kundërtën e pretendimit të paditësit (...) kërkuesi ishte në vështirësi objektive të njihej me gjendjen, pasi punonte në këtë zonë prej një kohe tepër të shkurtër (10 ditë) dhe atij nuk i është vënë në dispozicion regjistri i subjekteve tregtare të zonës, si dhe praktika e punës nga inspektori paraardhës (...) nuk është marrë në konsideratë nga i padituri shkalla e vështirësisë që ka një nëpunës publik për të ndërgjegjësuar një subjekt biznesi për të ndrequr parregullsitë (...) tri subjektet tregtare që ishin pa kasë fiskale faktikisht nuk mund të penalizoheshin nga paditësi, pasi afati i regjistrimit me kasë ishte shtyrë nga Ministria e Financave deri në fund të muajit shkurt 2011 (...) aktet e rikontrollit të ushtruara nga pala e paditur janë të parregullta, për shkak se nuk janë të firmosura nga të dy inspektorët por vetëm nga njëri prej tyre (...) shkeljet e konstatuara nuk janë të tilla që të motivojnë një masë të tillë disiplinore sikundër është “Largimi nga shërbimi civil”.

15. Ndërsa Gjykata e Lartë në vendimin e saj nuk i ka marrë në konsideratë faktet e mësipërme dhe nuk ka argumentuar se përse nuk qëndrojnë arsyetimet e bëra nga gjykatat më të ulëta, pavarësisht se i ka

prishur vendimet e tyre. Ajo ka bërë vetëm një përshkrim të procesit disiplinor, duke dhënë në paragrafin e fundit konkluzionin e saj se kërkuesi ka kryer shkelje të rënda disiplinore. Në vlerësimin e Gjykatës, Gjykata e Lartë nuk ka debatuar mbi faktet dhe provat e vlerësuara dhe të administruara nga gjykatat më të ulëta, por i ka anashkaluar ato. Sipas jurisprudencës kushtetuese, Gjykata e Lartë jo vetëm nuk ka kompetencën të administrojë prova të reja, por as nuk mund të anashkalojë ekzistencën e fakteve dhe të rrethanave që janë vërtetuar në gjykimin e faktit, t'i ndryshojë ato, ose të arrijë në konkluzione për faktet e çështjes që bien në kundërshtim me përfundimet e gjykatave më të ulëta (*shtb vendimin nr. 27, datë 24.6.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuetit për cenimin nga Gjykata e Lartë të parimit të gjykatës së caktuar me ligj, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, është i bazuar dhe duhet pranuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

#### VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës.
- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2014-2918, datë 18.9.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.
- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha,  
Dizdari, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Fatos Lulo

Vladimir Kristo, Besnik Imeraj, Gani